Bazuar në nenin 10 paragrafi 1 dhe paragrafi 6 nga Rregullorja për punë e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (tekst i pastruar) nr.01-3732/1 nga 29.07.2019, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuel në seancën e 18-të mbajtur më 16.05.2022, në lidhje me Propozimin nr.03-1798/3 nga 13.05.2021 për fillim të procedurës kundërvajtëse ndaj SHTR G-TV TELEVIZION SHPKNJP Gostivar për shkelje të nenit 92 paragrafi 1 nga LSHMAAV, miratoi si më poshtë:

# K O N K L U Z Ë

1. Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për kontrollin e kryer të mbikëqyrjes programore nr.10-1798/1 nga 27.04.2022 ndaj SHTR G-TV TELEVIZION SHPKNJP Gostivar ku përcaktoi shkelje të nenit 92 paragrafi 1 nga LSHMAAV.

2. Këshilli konkludoi ndaj SHTR G-TV TELEVIZION SHPKNJP Gostivar të inicohet procedurë kundërvajtëse pranë gjykatës kompetente pasi nga mbikëqyrja është konstatuar se transmeruesi i përmendur më 20 prill 2022, nuk ka transmetuar të paktën 30% program burimor vendas si vepra audiovizuele maqedonase, që është në kundërshtim me nenin 92 paragrafi 1 nga LSHMAAV.

3, Obligohet Sektori për punë juridike dhe furnizim publik të përgatisë Kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse pranë gjykatës kompetente për transmetuesin e përmendur.

4. Një kopje e konkluzës t'u dorëzohet:

- Udhëheqësve të të gjitha sektorëve të Agjencisë,
- Personit të emëruar nga Agjencia, për udhëheqjen e lëndëve për procedurë administrative,
- Sektorit për mbështetjen e punës së Këshillit të Agjencisë,
- Sektorit për mbështetje informative dhe punë të përgjithshme — arkivi i Agjencisë.

**Agjencia për shërbime medatike**
**audio dhe audiovizuele**
**Kryetar i Këshillit**
**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**

**Nr.02-1980/04**
**16.05.2022 Shkup**